



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1445/1prot.

Tiranë, më 02. 12. 2024

V E N D I M

Nr. 285, datë 02.12.2024

Mbështetur në ligjin nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ është paraqitur ankesa nr. 213 Regj., datë 22.10.2024, nga znj. M. B., e cila është autorizuar të përfaqësojë në këtë ankesë bashkëshortin e saj, z. M. B., kundër Komisionit Mjekësor Kempin Epror Para-Tetraplegjik, në të cilën pretendon diskriminimin e z. M. B., për shkak të “etnisë” dhe “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja parashtron se: “Më datë 13.11.2023, burri im, i quajtur M. B., ka pësuar hemorragji cerebrale dhe është shtruar urgjentisht në Spitalin Rajonal të Shkodrës, ku ka qëndruar në reanimacion nën mjekim intensiv. Nga spitali ka dalë më datë 12.01.2024, në gjendje të paralizuar nga gjymtyrët dhe të folurit.

Pas disa kohësh, kemi paraqitur kërkesë dhe kemi plotësuar dokumentet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shkodër për përfitim të statusit si tetraplegjik, pasi gjendja shëndetësore e tij vazhonte të ishte e rëndë. Ai është i paralizuar, i shtrirë në krevat, nuk ngrihet dot në këmbë dhe, për rrjedhojë, nuk ecën. Nuk flet që nga momenti i shtrimit dhe, pas daljes nga spitali, i është shfaqur edhe sëmundja e epilepsisë. Të gjitha nevojat personale i kryen në një krevat të lëvizshëm,

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtësën Komisioneri.

dhe të gjitha shërbimet, si ato higjienike dhe ushqimi, ia servirim po aty. Ndërkohë, vazhdon mjekimi i tij me ilaçet e caktuara nga mjeku specialist që e ka kuruar.

Më datë 04.07.2024, është mbledhur Komisioni Mjekësor për Caktimin e Aftësisë së tij, dhe, meqenëse ai nuk ishte në gjendje të përballonte udhëtimin nga Shkodra deri në Tiranë, nuk e paraqitëm të sëmurin në Komision. Në atë ditë, anëtarët e Komisionit bënë një video-call me telefon me mua, ku kërkuan ta shihnin të sëmurin, M. B., duke e zbuluar çarçafin me të cilin ishte i mbuluar dhe ndodhej, si gjithnjë, i shtrirë në krevat. Nuk bënë asnjë pyetje apo kërkesë tjetër. Për çudinë e të gjithëve, pas disa ditësh, na erdhi përgjigje negative nga Komisioni se ai nuk e përfiton statusin. Për këtë, kemi bërë ankesë përsëri për ta vlerësuar gjendjen e të sëmurit nga Komisioni i shkallës II. Ndërkohë, kam autorizuar verbalisht kunatin tim (vëllain e burrit tim) të interesohet në instancat shtetërore për këtë padrejtësi.

Kunati ka marrë takim me Drejtoreshën e Përgjithshme të Shërbimit Social në Tiranë, ku i ka shpjeguar situatën dhe pamundësinë për ta sjellë të sëmurin në Komision për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore të tij dhe, në çdo rast tjetër, në atë gjendje nuk do ta sillte të sëmurin në Komision. Ai i ka shprehur shqetësimin se Komisioni i shkallës I ka marrë një vendim të njëanshëm dhe shumë subjektiv, duke e paragjykuar të sëmurin. Drejtoresha i ka premtuar se do ta shqyrtonin rastin dhe ka angazhuar Dr. K., për të komunikuar me kunatin, me të cilin ka bërë të njëjtën bisedë dhe ia ka bërë të qartë se në Komisionin e shkallës II nuk do ta sillte në atë gjendje. Doktorin nuk ia ka bërë të qartë rregullin që rregullorja e Komisionit, në raste të tilla, parashikon: që 10 ditë përpara zhvillimit të Komisionit, nga të interesuarit, duhet të dorëzohet një prezencë (letër) me shkrim nga mjeku specialist mbi gjendjen e të sëmurit, dhe në kushte të tilla Komisioni mund t'i bëjë vizitë të sëmurit edhe në shtëpi. Por ai ka thënë: “Nuk të them dot, as ta sjellësh e as mos ta sjellësh, sikur ata po bënin ndonjë pazar.” Më datë 17.10.2024, jemi paraqitur në Komisionin e shkallës II (sërish të përfaqësuar nga kunati) pa të sëmurin, të cilit ai i ka shpjeguar arsyen e mos sjelljes së tij në Komision, por ata kanë insistuar që i sëmuri duhet patjetër të ishte prezent. I kanë kërkuar ta shohin përsëri në kamerë, si në rastin e parë, apo të pyesin mjekun specialist për gjendjen reale të të sëmurit, por nuk kanë pranuar as njërën e as tjetrën, duke e argumentuar se ajo është një e drejtë e Komisionit të shkallës I, të cilën ai Komision e ka ezauruar duke e parë në kamerë të sëmurin. Gjithashtu, kanë dokumentuar me shkrim se gjendja reale fizike e të sëmurit nuk përputhet me diagnozën e caktuar. Si përfundim, edhe Komisioni i shkallës II dha përgjigje negative, duke e lënë në fuqi vendimin e Komisionit të shkallës I.

Nga sa më sipër konstatoj:

1. Duket e qartë se Komisioni i shkallës I ka dhënë një vendim të padrejtë, duke e paragjykuar gjendjen e të sëmurit me një të parë me sy në distancë dhe pa bërë asnjë verifikim apo pyetje tjetër, siç duket përbuzja apo neveria ka dominuar mbi intuitën dhe njohurit mjekësore, duke e vënë në dyshim edhe diagnozën e caktuar nga mjekët specialistë (siç thotë vetë Komisioni i shkallës I).

2. Qëndrimi i mjekut të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social, z. K., është një qëndrim papërgjegjshmërie për detyrën, që nuk i përgjigjet as emrit dhe as qëllimit të institucionit ku ai punon. Një qëndrim që nuk ka për qëllim shërbimin ndaj qytetarit, por përcjelljen pa u zgjidhur punë, duke i diskriminuar edhe për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore. Nga muaji korrik që kemi kontaktuar me z. K., deri më datë 17.10.2024, kur është mbledhur Komisioni i shkallës II, është një kohë e gjatë dhe mund të kishim sjellë jo një, por disa letra për gjendjen shëndetësore dhe pamundësinë e të sëmurit për tu paraqitur në Komision.
3. Qëndrimi i Komisionit të shkallës II ka hapur një qëndrim arrogant, nepotik për të mbuluar gabimet e kolegëve të tyre të shkallës I, duke shkelur misionin e tyre human dhe betimin e Hipokratit, si dhe detyrën për të cilën kanë marrë përsipër të shërbejnë, duke justifikuar veprimet e tyre me rregullin e përgjithshëm se të sëmurit duhet të jenë të pranishëm në Komision, pa marrë parasysh disa të drejta që rregullorja parashikon në raste të tilla për të sëmurit rëndë.
4. Në të gjitha rastet gjatë qëndrimit dhe në kontaktet me punonjësit e administratës së Shërbimit Social, jemi ndeshur me pyetje si: "Çfarë është ky emër? Nga jeni ju me origjinë?" Ne i përkasim komunitetit Serbo-Malaz, por jemi shtetas shqiptarë dhe duhet të gëzojmë të gjitha të drejtat që na siguron Kushtetuta e vendit.

Ankuesja kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit, zgjidhjen e rastit të saj dhe që t'i jepet e drejta e statusit sipas ligjit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma "a", të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: "Diskriminim" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive

themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi", ndërsa në nenin 20, pika 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: "1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi....." 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:c) kontributin dhe mundësinë për të përfiturar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun".

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës nr. 213, datë 22.10.2024, rezultoi se ajo nuk ishte e plotë dhe për këtë arsye nuk mund të vazhdonte më tej shqyrtimi i saj. Me anë të shkresës nr. 1445/2 prot., datë 29.10.2024, Komisioneri i kërkoi ankueses që të plotësonte ankesën, veçanërisht për të paraqitur aktin e përfaqësimit të bashkëshortit të saj dhe sqarimin e shkakut të pretenduar të diskriminimit "aftësinë e kufizuar", në lidhje me vënien në dispozicion të dokumentit mjekësor që vlerëson gjendjen shëndetësore të z. M. B. Ankuesja ka plotësuar dhe saktësuar ankesën dhe e ka dorëzuar atë pranë Komisioneri, t administruar me nr. 1445/3 prot., datë 14.11.2024.

Pas plotësimit të ankesës, në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1445/4 prot., datë 18.11.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shkodër, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shkodër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Bashkia Shkodër, në cilësinë e institucioneve përkatëse, pasi legjislacioni në fuqi parashikon që secili prej këtyre institucioneve ka kompetenca dhe veprime të përcaktuara për procesin e vlerësimit të sëmurëve që kërkojnë përfitimin e statusit të paraplegjikëve.

- Me shkresën nr.2388/1 prot., datë 21.11.2024² Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shkodër, ka njoftuar Komisionerin se: *Me shkresën nr. 8994 prot., datë 20.11.2024 nga Drejtoria e Komisioneve të PAK në Shërbimin Social Shtetëror është dërguar dosja e z. M. B. Sipas Vendimit të KMCAP-it Epror për paraplegji, është vlerësuar përfitues i statusit të paraplegjisë për periudhën 01.07.2024- 01.07.2026. Me shkresën nr. 2418 prot., datë 21.11.2024 Drejtoria Rajonale ka proceduar me dërgimin e dosjes pranë Njesisë Administrative Gruemirë për procedimin me pagesa sipas vendimit të KMCAP-it Epror.*
- Me shkresën nr. 1445/8 prot., datë 26.11.2024, është administruar pranë Komisionerit deklarata e datës 22.11.2024 e znj. M. B., në të cilën ajo deklaron se: *Inderuar Komisioner, lidhur me ankesën time për diskriminim nga ana e Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar Epror, për bashkëshortin tim M. B., unë e tërheq ankesën time për arsye se, edhe pse me vonesë, Komisioni Epror, pasi shqyrtoi për të tretën herë gjendjen shëndetësore të M. B., arriti në konkluzion dhe i dha statusin e të sëmurit. Ju falenderoj familjarisht për angazhimin tuaj në zgjidhjen e këtij problemi."*

Në këtë situatë, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga znj. M. B., e cila me anë të deklaratës, datë 22.11.2024 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës

² Administruar pranë Komisionerit me nr. 1445/7 prot., date 25.11.2024.

duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pikat 9 e 10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 213, datë 22.10.2024, të paraqitur nga ankuesja znj.M. B., e cila përfaqëson në këtë ankesë bashkëshortin e saj, z. M. B., kundër Komisionit Mjekësor Kempin Epror Para-Tetraplegjik, për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA